

SHARRCEM



Buletin



Numër 91, Maj-Qershor 2009

Dita e Kapur



Kompania Sharrcem është e njohur për seriozitetin profesional dhe suksesin e jashtëzakonshëm që ka arritur për 9 vjetët e operimit të saj. Përmirësimet teknike dhe ambientale kanë arritur në një nivel shumë të lartë me investime të shumta nga ana e kompanisë si dhe me përkushtimin e punëtorëve. Arritje të mëdha janë shënuar edhe në sigurinë në punë ku aksidentet në punë qëndrueshmërisht kanë rënë në 0. Sharrcem gjithashtu është e njohur për financimin e projekteve të ndryshme komunitare si dhe përkrahje individuale.

Për të gjitha këto arritje janë të informuar të gjithë qytetarët në mënyrë indirekte, përmes mediave, takimeve të ndryshme, Buletinit tone mujor, përmes vetë punëtorëve. Por ndryshe nga këto burime informative, Sharrcem kësaj here vendosi t'i njoftoj qytetarët direkt rreth përmirësimeve në fabrikë duke iu mundësuar atyre të i shohin gjërat për

(vijon në faqe 3-4)



z.Patrick Stapfer
ZKE i kompanisë SHARRCEM



Dita e

(vijon nga faqja 1)



se afërmi, duke iu dhënë mundësinë të i vizitojnë edhe objektet tjera operative në fabrikë.

Me këtë rast Kompania organizoi një ditë të hapur me shumë aktivitete ku secili do të ishte i mirëpritur.

Dita e hapur u organizua me 30 maj duke filluar në ora 12.00.

Menagjimenti së bashku me të gjithë punëtorët ishin të angazhuar në pritjen e mysafirëve dhe angazhimeve tjera organizative.

Pjesëmarrës ishin të gjithë punëtorët dhe familjarë të tyre, përfaqësues të autoriteteve lokale, përfaqësues të policisë dhe Kforit, përfaqësues të institucioneve të ndryshme si dhe qytetarë të shumtë që arrin një numër rreth 4000 persona.

Për të gjithë të pranishmit Sharrcem kishte dyer të hapura ku i mirëpriti me shumë aktivitete kulturore me ushqim dhe pije, si dhe me nga një dhuratë simbolike bluzë me kapelë me logo të Sharrcem-it.

ZKE i Kompanisë hapi evenimentin duke i përshëndetur dhe falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe për ndihmën e dhënë, veçanërisht punëtorët që pa



Hapur

përkushtimin e tyre nuk do të ishim sot këtu ku jemi. Gjithashtu Z. Patrick përmendi të arriturat në të gjitha sektoret e kompanisë, kontributin e dhënë për komunitetin dhe donacione në projekte të shumta si dhe u zotua për vazhdimësi të këtyre përkrahjeve.

Më pas ia dha fjalën Z. Zharku – Ministër i Tregtisë dhe Industrisë që zyrtarisht ta hapë evenimentin. Gjithashtu Z. Zharku falënderoi Sharrcem-in për këtë organizim dhe e cilësoi Holcim-in si një investitor shumë serioz dhe të suksesshëm që mund të jetë një shembull i mirë për investitorë të tjerë.

Evenimenti vazhdoi sipas skemës së planifikuar.

Poashtu edhe fëmijët patën rastin të shohin nga brenda ambientin ku prindërit dhe të afërmit e tyre punojnë për të ju siguruar një të ardhme më të mirë. Patën mundësinë të luajnë në një kopsht të improvizuar me shumë lodra.

Një eveniment i tillë u organizua për nderë të punës së palodhshme të punëtorëve dhe për komunitetin në përgjithësi dhe që të gjithë u ndanë të kënaqur nga kjo ngjarje.



BLERËSIT TANË



Nga blerësit e kompanisë SHARRCEM në regjionin e Prizrenit, si prodhues i elementeve të betonit, është edhe ndërmarrja "Fortesa" me pronar z. Sami Kabashi. Dhe intervistën e radhës, e realizuam me këtë ndërmarrje.

"Në fillim, thotë z. Kabashi, ju dëshiroj mirëseardhje në "Fortesa" dhe jemi që të gjithë, të kënaqur me këtë vizitë tuajën, e cila edhe një herë dëshmon për interesimin e kompanisë SHARRCEM ndaj blerësve të vet."

Z. Kabashi ju në "Fortesa" për aktivitet kryesor keni prodhimin e elementeve të betonit, ku pjesëmarrja e çimentos është e domosdoshme. Sa jeni të kënaqur me cilësinë e çimentos së SHARRCEM - it?

"Me vet faktin që ne jemi përdorues të çimentos së juaj dhe kemi një furnizim që nga viti 2000, tregon ndoshta më së miri edhe me vet cilësinë e çimentos së ofruar. Këte, e konfirmojnë edhe blerësit tanë dhe deri më tani, nuk kemi patur asnjë reklamacion. Me një fjalë nuk kemi asnjë vërejtje rreth cilësisë së ofruar."

Pos cilësisë së çimentos, që edhe ju po e konfirmoni a jeni të kënaqur me nivelin e shërbimeve tjera që ofron kompania SHARRCEM?

"Po edhe kjo është me shumë interes të theksoj, se shërbimet e ofruara në vazhdimësi kanë një progres. Kjo rezulton nga raportet e mira dhe kontaktet e ndryshme



sidomos me Departamentin e Shitjes e Marketingut, që në kontinuitet na lajmëron dhe informon për të gjitha ato aktivitete të kompanisë së juaj e që janë me interes për ne."

Si e vlerësoni bashkëpunimin e deritanishëm me kompaninë SHARRCEM duke patur parasysh edhe këtë periudhë të këtij viti?

"Vitin e kaluar e kemi përmbyllur me sukses dhe jemi të kënaqur sa i përket bashkëpunimit. Prodhimet tona në "Fortesa" falë cilësisë së çimentos, kanë arritë standardet e larta që i kërkon tregu. Edhe gjatë këtyre muajve, kemi aktivitete të mira. Të jem i sigurtë, ka një drojtje të të gjithë prodhuesit, investitorët dhe operativa ndërtimore për shkak të krizës ekonomike, që mund të reflekton në një zvogëlim të kapaciteteve tona."

Z. Sami a keni edhe diçka tjetër për të thënë?

"Jo. Mendoj se i thamë të gjitha ato që janë më kryesore. Ne do të vazhdojmë të punojmë me kompaninë SHARRCEM edhe më tej."

Z. Sami, ju faleminderit për këtë bashkëbisedim! "Edhe unë në emër të "Fortesa" dhe në emrin tim, ju falënderoj për këtë vizitë dhe jemi krenar për te."



mbajmë premtimet!
SHARRCEM

PËRFAQËSUES TË KOMPANIVE TË EVROPËS JUGLINDORE
NË KUADËR TË HOLLCIM

VIZITUAN KOMPANINË SHARRCEM

Kompania SHARRCEM, për herë të parë ishte mikpritëse e përfaqësuesve të kompanive të Evropës Juglindore, që operojnë në kuadër të familjes së madhe Holcim dhe atë në nivelin e drejtorëve teknik.

Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i kompanisë SHARRCEM, z. Patrick Stopfer së bashku me anëtarët e Bordit Menaxhues të kompanisë, organizoi dhe bëri një prezantim të hollësishëm me video prozhektor për mysafirët. Gjatë këtij prezantimi, z. Stopfer, i njoftoi të pranishmit mbi ecjen dhe progresin e arritur gjatë

këtyre viteve në SHARRCEM duke përfshirë të gjitha aktivitetet nëpër objekte dhe vija të ndryshme teknologjike, futjen e teknologjive të reja, mbrojtjen dhe sigurinë në punë, krijimin e një ambienti vërtetë ekologjik, infrastrukturë të mirë, raportet shumë të mira me komunitetin dhe zhvillime të tjera me interes për vetë punëtorët e kompanisë SHARRCEM në një rën anë dhe në anën tjetër avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj blerësve të vet.

Pas këtij prezantimi të hollësishëm, mysafirët të shoqëruar me Ekipin Menaxhues dhe menaxherë të tjerë, i bënë një vizitë shumë objekteve dhe vijave të tjera teknologjike, duke shprehur interesimin e tyre për funksionimin e tyre dhe zgjidhjeve tekniko-teknologjike të ndërmarrja. Për të gjitha këto interesime, menaxherët e kompanisë SHARRCEM, dhanë shpjegimet e tyre profesionale dhe të detajuara.

Në fund të theksojmë se vizita ishte e suksesshme dhe se opinionet e përfaqësuesve të



SHARRCEM DHURON;

LODRA PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS

Kompania SHARRCEM, kohë më parë vendosi që nxënësve të Shkollës Filllore "Ilaz Thaqi" në Han të Elezit, të ju dhurojë disa lodra me qëllim të argëtimit të tyre në hapësirën e kësaj shkolle. Ishte vetë Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i kompanisë SHARRCEM, z. Patrick Stapfer, që vendosi të vizitonte shkollën "Ilaz Thaqi" me rastin e dorëzimit të lodrave. Ai i shoqëruar nga drejtori i kësaj shkolle dhe një numër pedagogësh vizituan lokalet e shkollës dhe u njoftuan mbi



kushtet e zhvillimit të procesit mësimor. Me këtë rast, stafi i shkollës shprehu falënderimet për përkrahjet dhe ndihmat e ofruara nga kompania SHARRCEM dhe gatishmëri për pjesëmarrje të kësaj shkolle në ndonjë aktivitet të përbashkët siç është mbrotja e ambientit apo pastrimi i hapësirave të ndryshme në Han të Elezit. Në fund, nuk mungoi edhe një fotografi e përbashkët në shenjë kujtimi të kësaj vizite.

SHITJA GJATË PESË MUAJVE
TË KËTIJ VITI NË SHARRCEM

REALIZIM I PLOTË I PLANIT

Të gjitha detyrat e planifikuara në drejtim të shitjes dhe përcjelljes së sasive të produkteve të kompanisë SHARRCEM për periudhën janar - maj 2009, sipas menaxherit të Departamentit të Shitjes e Marketingu, z. Naxhid Raka, janë përbushur në tërësi. Me këtë, gjithnjë sipas z. Raka, kemi arritur që kërkesat e blerësve tanë t'i përbushim me sukses të plotë, çka për ne, duke shtuar edhe avancimin e kryerjes së shërbimeve më cilësore, paraqet angazhim dhe detyrim të përhershëm.

Në përbushjen e planit pesëmuajorësh, meritore ishin aktivitetet në muajin prill dhe maj. Rezultatet e këtyre dy muajve arritën që t'i shkrijnë ngecjet në tre muajt e parë, kur për shkak të kushteve të vështira atmosferike, kërkesat ishin të pakësuara.

